



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.19/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e Gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit E. R., avokat nga Prizreni, ndaj gjyqtarit G.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Penal, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës penale P.nr. 1216/22, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.09.01.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit E. R., avokat nga Prizreni, ndaj gjyqtarit G.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Penal, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës penale P.nr. 1216/22.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës av. E. R. nga Prizreni, ka parashtruar Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit G.K., Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës P.nr.1216/22.

Ankuesi Av.E. R. në Propozim ka cekur se ai është mbrojtësi i të akuzuarit B.U., sipas lëndës penale P.nr.1216/22 cili është gjykuar dhe dënuar për veprën penale kanosje nga neni 181 par.2 të KPK me burgim në kohëzgjatje prej 7 muajve me dt. 12.10.2023. Gjyqtari gjykues sipas kësaj lënde është G.K., i cili sipas ankuesit gjatë gjykimit dhe administrimit të provave ka vepruar në kundërshtim të nenit 7 të KPP dhe ka administruar provat të cilat nuk janë propozuar me aktakuzë, ka refuzuar provat të propozuara nga ana e mbrojtjes dhe me këtë ka nxjerr një aktgjykim të kundërligjshëm i paraparë sipas nenit 425 të KPK. I akuzuari B.U., përndryshe është i moshës së shtyrë, i ka 78 vjet. Gjyqtari vendimin e vet e ka bazuar në provat të cilat nuk janë propozuar dhe administruar si janë Aktgjykimet dënuese të mëhershme të akuzuarit, kurse nuk i aprovon për administrim si provë Aktgjykimet e propozuara nga ana e mbrojtjes të cilat janë lirues dhe me këtë edhe e ashpëron dënimin ndaj të akuzuarit si recidivist. Bazuar në të lartcekura ka kërkuar që të ndërmerren masa disiplinore ndaj gjyqtarit.

Gjyqtari në deklaratën e tij lidhur me pretendimet e ankuesit ka cekur se është e vërtetë që ai ka qenë i ngarkuar dhe ka gjykuar në lëndën penale P.nr. 1216/22 ku si i akuzuar është B.U., për veprën penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPK ku si mbrojtës ka qenë avokati E. R. nga Prizreni. Si gjyqtar Gjykues, Gjyqtari G.K., ka deklaruar se ka zhvilluar procedurën e gjykimit duke respektuar të drejtën në Liri dhe Siguri nga neni 29 par. 1 të Kushtetutës së Kosovës si dhe duke respektuar nenet 7, 159 dhe 250 të KPRK —së konsideron se ka vepruar drejt dhe në mënyrë të paanshme. Sa i përket provave të administruara ka cekur se të njëjtat janë prova të cilat vërtetojnë se i akuzuari është recidivist dhe se ka disa aktgjykime dënuese për vepër penale të ngjashme dhe se këto aktgjykime

janë përmendur edhe gjatë shqyrtimit nga ana e avokatit të palës së dëmtuar , por se nuk ka konsideruar se të njëjtat duhet të administrohen në procedurë të provave dhe se duhet vetëm të listohen si rrethana rënduese për të akuzuarin. Në fund gjyqtari ka cekur se nuk ka bazë për ndërmarrjen e masës disiplinore ndaj tij pasi që ka vendosur drejt dhe në mënyrë të paanshëm në pajtim me të gjitha parimet e drejtësisë.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar Ankesë ndaj gjyqtarit G.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, lidhur me lëndën penale P.nr.1216/22 ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës P.nr.1216/22. Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si Vijon:

Ankuesi avokati E. R., nga Prizreni është mbrojtësi i të akuzuarit B.U., nga fshati Lubinje e Epërme , Komuna e Prizrenit, në çështjen penale P.nr.1216/22 i akuzuar për veprën penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPK , ku si i dëmtuar është R.B., nga fsh. Lubinje e Epërme , Komuna e Prizrenit të cilin e përfaqëson avokati E.G., nga Prizreni. Gjyqtari G.K., është ngarkuar me këtë lëndë dhe të njëjtën e ka gjykuar dhe me dt. 12.10.2023 ka vendosur dhe shpallur Aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit B.U., . Me shikimin në shkresa të lëndës është vërtetuar se janë mbajtur disa shqyrtime gjyqësore ku janë dëgjuar dëshmitarët dhe janë administruar provat dhe se i gjithë procesi ka pasur rrjedhën normale të gjyqimit. Në fund gjyqtari ka vendosur me aktgjykim ku e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar të akuzuarin B.U., me dënim me burgim prej 7 muajve si dhe e ka obliguar për pagesën e shpenzimeve gjyqësore , kurse të dëmtuarin R.B., për realizim të kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil. Në arsyetim të aktgjyqimit si rrethanë rënduese gjyqtari ka cekur se i akuzuari është recidivist për vepër të ngjashëm penale dhe me këtë rast i ka listuar aktgjykimet dënuese të mëparshme ndaj tij. Për këtë rrethanë Av. E. R. , në rastin tonë ankuesi ka pasur vërejtje dhe ka parashtruar propozim për inicim të procedurës disiplinore.

Autoriteti Kompetent —Kryetarja e Gjykatës në rastin konkret konsideron se sa i përket mënyra e udhëheqjes së procedurës dhe mënyra e vendosjes gjatë gjyqimit është në kompetencë të gjyqtarit. Kjo është e përcaktuar me nenin 7.1 dhe nenin 8 të KPP , gjithashtu procedura e provave dhe rregullat e përgjithshme të paraqitjes së provave është bazuar në nenet sipas nënkapitullit të X , XI dhe XII të KPP-së dhe është obligim i gjyqtarit gjykues ti zbatojë dhe respektojë të njëjtat. Moszbatimi i këtyre neneve dhe dispozitave paraqet shkelje procedurale dhe për këtë mund të parashtrohet mjet juridik —ankesë në gjykatën e shkallës më të lartë. Në rastin konkret nëse ka pasur Shkelje procedurale gjatë gjyqimit kjo mund të ankimohet dhe të shqyrtohet nga ana e Gjykatës së Apelit dhe se nuk është kompetencë e Kryetarit të gjykatës që të vendos nëse ka Shkelje procedurale, por Kryetari vendos nëse ka shkelje disiplinore të veprimeve të gjyqtarit sipas nenit 5 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore . Gjithsesi Ankuesi ka ushtruar Ankesë në afatin ligjor ndaj Aktgjyqimit P.nr.1216/22 në Gjykatën e Apelit dhe kjo gjykatë është kompetente për vendosje sipas ankesës dhe pretendimeve në ankesë.

Andaj si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideron se gjyqtari G.K., në veprimet e tija nuk ka pasur Shkelje të Cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me nenin 5 par.1 nënpar.1.3 dhe nenin 5 par.2 nënpar.2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të

Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë trajtimi me ligj i palëve në procedurë gjatë ushtrimit të detyrës së saj zyrtare si Gjyqtar.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligiit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.19/2023,

Datë 09.01.2024

Gjykatës Themelore në Prizren

Shpresa Emra

The image shows a circular official stamp of the Basic Court in Prizren. The text around the perimeter of the stamp includes "GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN" and "OSNOVNI SUD U PRIZRINU". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e paraparë e drejta e ankesës.